



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

**MBI HARTIMIN E PROGRAMIT EKONOMIK DHE FINANCIAR TË VEPRIMTARISË SË
ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE PËR VITIN 2025.**

Në mbështetje të Ligjit Nr.7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, i ndryshuar, VKM Nr. 198, datë 04.05.1993 “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave“, i ndryshuar, si dhe Statutin e EKB-së nr. 10584/3 prot, datë 02.10.2024, ju parashtrojmë treguesit kryesorë të Programit Ekonomik të Entit Kombëtar të Banesave për vitin 2025.

Për hartimin e këtij projekt-programi jemi mbështetur :

- Në analizën e treguesve ekonomiko financiare të realizuar nga EKB në vitin 2023.
- Në analizën e treguesve ekonomiko financiare të realizuar gjatë 10 mujorit, dhe në të pritshmin e vitit 2024.
- Në strategjinë e zhvillimit dhe objektivat që janë caktuar për vitin 2025.
- Programi Ekonomik është hartuar në bazë të legjislacionit në fuqi, ku në çdo periudhë të vitit mund të bëhen rishikime dhe rialokimet e fondeve sipas nevojave duke marrë parasysh gjendjen financiare të shoqërisë,

Projekt-programi ekonomik dhe financiar i EKB-së , trajton çështjet kryesore si vijon:

- I.** Objektivat e programit ekonomik dhe financiar.
- II.** Planifikimi i treguesve ekonomik dhe financiar të veprimitarisë.
- III.** Planifikim dhe detajimi i planit të investimeve ndërtimore.
- IV.** Planifikimi i aktiviteteve mbështetëse.

I. Objektivat e Programit Ekonomik dhe Financiar.

Enti Kombëtar i Banesave në këtë projekt-program ka parashikuar burimet për sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për vazhdimimin e veprimtarisë së tij, në planifikimin e investimeve të reja si dhe vazhdimin e ndërtimeve të nisura gjatë vitit 2023 dhe para tij.

Në varësi të programimit të treguesve kryesor, janë përcaktuar objektivat e Entit Kombëtar të Banesave për vitin 2025, të cilat i paraqiten Këshillit Drejtues për miratim, së bashku me programin ekonomiko-financiar, si më poshtë:

- Të realizojë të ardhurat në shumën **201,670,000 lekë** gjatë aktivitetit ekonomik dhe financiar dhe të mbajë nën kontroll shpenzimet e veprimtarisë për **179,071,400 lekë**. (ose **193,285,000 lekë** me miratimin e shtesës së strukturës organike)
- Të realizojë një rezultat financiar (fitim bruto) në shumën **22,598,600 lekë** (ose **8,385,000 lekë** me miratimin e shtesës së strukturës organike)
- Në fushën e investimeve të realizohet;
 - Përfundimi i banesave të nisur nga viti 2021, 2022 dhe 2023 në qytetet Vlorë, Has, Delvinë dhe Roskovec.
 - Fillimi i ndërtimit të banesave të reja për të pastrehët në qytetet Shkodër, Korçë, Lushnjë, Berat, Burrel, Peshkopi dhe Shijak, të miratuara nga KD.
 - Ndërtim të banesave në Librazhd dhe Gramsh.
- Të realizohet gjatë vitit, strehimi i 168 familjeve, nëpërmjet shitjes së apartamenteve të banesave të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së, nga të cilat në Vlorë 75 ap., Has 35, Delvinë 29 dhe Roskovec 29.
- Të bëhet e mundur shitja e 19 njësive të shërbimit dhe 44 garazheve të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së, nëpërmjet ankandeve të njësive të shërbimit dhe garazheve, nga të cilat: 3 njësi shërbimi në Fier, 3 garazhe në Korçë, 8 garazhe në Maliq, 11 garazhe dhe 6 njësi shërbimi në Burrel, 2 njësi shërbimi në Kukës, 22 garazhe dhe 8 njësi në Vlorë.
- Të ulet numri i klientëve debitorë në nivelin 15 % ose 70 debitorë të trashëguar nga gjëndja vitit 2024.

II. Programimi i Treguesve Ekonomik dhe Financiar të Veprimtarisë.

A. Planifikimi i të Ardhurave

Të ardhurat janë parashikuar mbi bazën e produktit të gatshëm (apartamente, njësi shërbimi dhe garazhe) në dispozicion për të shitur, si në banesat e reja ashtu edhe banesat për privatizim, si dhe përdorimin me efektivitet të burimeve ekzistuese të EKB.

Burimet kryesore të të ardhurave financiare për vitin 2025 për Degët Rajonale dhe Drejtorinë e Përgjithshme të EKB-së do të jenë si më poshtë:

- a) Të ardhurat nga shitja e apartamenteve të banesave të ndërtuara ndër vite nga EKB me fondet e Buxhetit të Shtetit dhe donatorëve të ndryshëm
- b) Të ardhurat nga shitja e apartamenteve të banesave të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së në Vlorë, Has, Rroskovec dhe Delvinë
- c) Të ardhurat nga 5%, ku përfshihen pagesa e shpenzimeve operacionale për EKB-në sipas vlerave të kontratave të reja të programuara për shitjen e apartamenteve dhe njësisve të banimit të ndërtuara me fondet e EKB si dhe 4% nga privatizimi i objekteve me VKM.
- d) Të ardhurat nga shitja e njësisve të banimit të objekteve të privatizuara me VKM dhe lidhja e kontratave të reja nga Degët Rajonale në Tiranë dhe Durrës.
- e) Të ardhurat nga shitja e njësisve të shërbimit dhe garazhet në Fier, Korçë, Maliq, Kukës, Vlorë, Has, dhe Burrel.
- f) Të ardhurat nga interesat e kontratave të lidhura ndër vite dhe nga ato që do të lidhen gjatë vitit 2025.
- g) Të ardhurat nga interesat e depozitave bankare për fondet e lira të EKB-së.
- h) Të ardhura të tjera ku përfshihen, të ardhurat nga parkimi i mjeteve të të tretëve, të ardhurat nga qiratë, gjobat e penaltitetet, etj.

Programi i të ardhurave sipas zërave kryesor, për Degët Rajonale të EKB-së dhe për Drejtorinë e Përgjithshme paraqitet si më poshtë:

PROGRAMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2025

Në lekë


NR	Emertimi	Te ardhura neto nga shitja dhe privatizimi	Te ardhura nga 4% & 5%	Të ardhura nga interesat e kredive	Të ardhura Interesa depozita dhe bankare	Të ardhura te tjera	TOTALI (Bruto)	PROGRAM I 2025 (Neto)	I pritshmi 2024	Plani 2024
1	TIRANE	22,200,000	772,000	4,357,200		612,000	27,941,200	27,941,200	31,293,917	24,173,400
2	FIER	2,501,200	4,503,240	4,550,560		30,000	104,041,620	11,585,000	4,280,800	5,292,400
3	DURRES	33,472,300	1,673,760	6,147,140	12,000	100,000	41,405,200	41,405,200	52,739,870	52,559,000
4	BERAT	-		1,224,000		100,000	1,324,000	1,324,000	1,489,200	1,722,500
5	KORCE	887,500	20,000	6,480,000	4,800	172,800	15,054,000	7,565,100	7,395,308	8,031,800
6	GJIROKAS TER	3,031,000	4,145,000	549,000		34,000	75,385,000	7,759,000	1,460,998	5,944,700
7	SHKODER	4,142,720	146,600	2,886,880	4,000	60,000	15,381,580	7,240,200	10,806,707	7,273,300
8	ELBASAN	-		4,336,700	12,000	1,100,000	5,448,700	5,448,700	11,783,989	7,185,500

Adresa: Rr. e Kavajës, ndërtesa nr.80, hyrja 1, kati 5, (ish shtëpia botuese Naim Frashëri) Tiranë, Shqipëri Tel: +355 42 227 796, email: info@ekb.gov.al; www.ekb.gov.al

9	VLORE	18,007,660	9,597,010	6,806,530	1,000	80,000	249,837,960	34,492,200	44,808,304	33,345,400
10	KUKES	8,996,660	5,143,600	10,533,740	-	45,600	147,485,160	24,719,600	14,655,217	22,264,000
11	DIBER	3,196,100		2,154,600	2,000	101,000	18,792,900	5,453,700	6,781,916	11,505,000
12	LEZHE	75,940	123,450	1,511,350	-	1,625,360	6,346,500	3,336,100	2,595,665	2,989,000
13	Dr. PERGJITH	-			18,000,000	5,400,000	23,400,000	23,400,000	17,000,000	17,300,000
	TOTALI	96,511,080	26,124,660	51,537,700	18,035,800	9,460,760	731,843,820	201,670,000	207,091,891	199,586,000

PROGRAMI I TE ARDHURAVE SIPAS ZERAVE PER VITIN 2025

- Te ardhura neto nga shitja dhe privatizimi
- Te ardhura nga 4% & 5%
- Të ardhura nga Interesat e kredive
- Të ardhura Interesa depozita dhe bankare
- Të ardhura te tjera



Siç del nga pasqyra e mësipërme, në planin e të ardhurave për vitin 2025, të ardhurat nga shitja dhe privatizimi (apartamente + njesi shërbimi + garazhe) zënë 48 % të të ardhurave në total. Të ardhurat nga 4% dhe 5% për shpenzimet operacionale zenë 13%, të ardhurat nga interesat e kontratave 25%, të ardhurat nga interesat e depozitave bankare 9%, dhe të ardhurat e tjera 5%.

Më hollësisht programi i treguesve kryesor të të ardhurave nga shitja paraqiten si më poshtë:

Planifikimi i të Ardhurave nga Shitja e Apartamenteve,

Gjatë vitit 2025 parashikohen të ardhura neto nga shitja rreth **71,400 mijë lekë**, nga lidhja e rreth 242 kontrata të reja në banesat e ndërtuara me fondet e veta të EKB-së, nga të cilat, Vlorë 75 ap., Has 35, Shkodër 4, Delvina 29, Rroskoveci 29, dhe privatizime nga të cilat Tirana 32, Durrësi 26, Korça 4, Shkodra 6 dhe Lezha 2.

Planifikimi i të Ardhurave nga Shitja e njësive të shërbimit dhe garazheve

Gjatë vitit 2025 janë planifikuar të shiten njësitë e shërbimit dhe garazhet për të cilat janë parashikuar shitja e 19 njësive të shërbimit dhe 44 garazheve të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së, nëpërmjet ankandeve të njësive të shërbimit dhe garazheve, nga të cilat: 3 njësi shërbimi në Fier, 3 garazhe në Korçë, 8 garazhe në Maliq, 11 garazhe dhe 6 njësi shërbimi në Burrel, 2 njësi shërbimi në Kukës, 22 garazhe dhe 8 njësi në Vlorë që së bashku zenë shumën e të ardhurave neto rreth **25,600 mijë lekë**.

Të Ardhura nga Interesat e Kontratave të Lidhura

Gjatë vitit 2025, janë planifikuar të realizohen të ardhura nga interesat e kontratave të lidhura të klientëve që kanë përfituar apartamente, të ndërtuara nga EKB me fondet e Buxhetit të Shtetit, Bankës Botërore dhe donatorë të tjerë.

Të ardhurat nga interesat e kontratave të lidhura për këto apartamente, programohen në shumën prej **51,537 mijë lekë**.

Të Ardhurat nga 4% & 5% i Shpenzimeve Operacionale

Për vitin 2025 janë planifikuar të realizohen të ardhura nga 5% (shpenzime operacionale të EKB-së) nga shitja e apartamenteve të reja (Vlorë, Has, Delvinë dhe Rroskovec) si dhe të ardhura nga 4% për apartamente të tjera të ndërtuara ndër vite me fondet e Buxhetit të Shtetit, si dhe nga privatizimet e njësive të banimit të objekteve me VKM.

Për këtë vit janë programuar gjithësej në shumën 26,124 mijë lekë, nga e cila për shitjet e apartamenteve në shumën **23,388 mijë lekë**, dhe nga privatizimet e njësive të banimit të objekteve me VKM në shumën **2,736 mijë lekë**.

Të Ardhurat nga Interesat e Depozitave Bankare

Mbështetur në gjendjen e depozitave dhe mirëmenaxhimin e fondeve të lira monetare të Drejtorisë së Përgjithshme, për vitin 2025 janë planifikuar interesat nga depozitat bankare me afat maturimi një vjeçar dhe 6/mujor si dhe interesa të tjera bankare në shumën **18 milion lekë**.


Të Ardhura të Tjera.

Këtu përfshihen të ardhurat e programuara nga shitja e biletave për parkimet e automjeteve në shumën **5,400 mijë lekë**, si dhe të ardhurat nga kamatë-vonesat, penalitetet dhe të tjera në shumën **4,061 mijë lekë**.

Programimi i të ardhurave të programuara për vitin 2025 sipas zërave kryesor krahasuar me pesë vitet paraardhëse (Plan-Fakt) paraqiten si vijon:

000 lekë

N R	Të Ardhurat sipas zërave	2020		2021		2022		2023		2024		Programi 2025
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	I pritsh.	
1	Të ardhurat nga shitja	49,230	25,862	39,477	29,375	40,731	52,790	27,139	11,046	37,661	50,200	37,742
2	Të ardhura nga 4%	3,915	5,486	17,001	6,027	24,856	14,975	21,198	5,217	30,682	18,137	26,125
3	Privatizimet me VKM	38,225	38,268	42,718	40,986	43,185	94,546	45,986	92,270	65,700	75,485	58,769
4	Nga interesat e kontratave	39,237	41,683	37,899	40,723	41,490	40,934	69,512	45,672	45,364	45,442	51,538
5	Interesat e depozitave	17,030	18,465	9,250	11,009	6,106	6,426	9,289	14,744	13,855	14,500	18,036
6	Të ardhura të tjera	7,261	9,597	7,753	20,630	6,718	8,404	6,545	19,716	6,324	3,328	9,461
TOTALI		154,900	139,362	154,100	148,752	163,086	218,077	179,669	188,665	199,586	207,092	201,670



Siç del edhe nga të dhënat e tabelës si më sipër, rezulton se planifikimi i të ardhurave për vitin 2025 parashikohet në masën 1% më shumë se plani 2024 ose në vlerë 2,084 mijë lekë, dhe në masën 2.6% më pak, ose 5,400 mijë lekë më pak se i pritshmi 2024, të cilat sipas zërave kryesor janë programuar si vijon:

- “Të ardhurat nga shitja” e apartamenteve dhe njësive të shërbimit janë planifikuar 81 mijë lekë më shumë nga plani 2024 por 12,457 mijë lekë më pak se i pritshmi 2024, kjo për shkak se:
 - a. Krahasuar me planin 2024, për vitin 2025, janë riplanifikimit të banesave të papërfunduara gjatë 2024(Vlorë,Has, Delvinë) është planifikuar shitja e apartamenteve të banesës së Rroskovecit
 - b. Krahasuar me të pritshmin 2024, është më e ulët për shkak se gjatë vitit 2024 janë shitur 75 apartamentet në Vlorë, shumë prej të cilave rezultuan me sipërfaqe tepër, për pasojë i pritshmi 2024 është më i madh se plani 2024. Përveç kësaj në të ardhurat nga shitja e apartamenteve , ndikon shumë vlera e truallit e cila ndryshon nga qyteti në qytet.
- “Të ardhurat nga privatizimet”, janë planifikuar në masën 6,931 mijë lekë më pak se plani i vitit 2024, dhe 16,716 mijë lekë më pak se i pritshmi 2024, i cili është tejkaluar nga privatizimi i objekteve të ish ushtarakëve i paplanifikuar. Në këtë kategori një peshë të konsiderueshme zë privatizimi i apartamenteve të ish depove të duhan cigares, ku pjesa më e madhe (118 nga 144 janë privatizuar) pra kanë ngelur vetëm 26 apartamente të cilat i kemi planifikuar për 2025, megjithëse kanë paraqitur veshtirësi nga banorët për arsye të ndryshme. Në përgjithësi privatizimet mbartin problematika të ndryshme të mbartura në vitë.
- “Të ardhurat nga 4% & 5%” janë planifikuar në masën 4,557 mijë lekë më pak se plani i vitit 2024 dhe 7,988 mijë lekë më shumë se i pritshmi 2024. Kjo për shkak se për vitin 2025 janë planifikuar më pak kontrata për apartamente në krahasim me planifikimin e 2024, por më shumë nga sa u lidhën në fakt gjatë vitit 2024.
- Të ardhurat nga interesat e kontratave janë planifikuar 6,174 mijë lekë më shumë se plani 2024 dhe 6,095 mijë lekë më shumë se i pritshmi 2024, kjo pasi gjatë vitit 2024 janë shtuar klientët e 75 apartamenteve të shitura në Vlorë, 25 apartamenteve të shitura në Tropojë si dhe disa klientë nga privatizimet, gjithashtu janë planifikuar të shtohen nga shitjet e programuara për vitin 2025.
- Të ardhurat nga interesat e depozitave janë dhe interesat bankare të cilat janë planifikuar në masën 12% më shumë se 2024 për shkak të rritjes së normave të interesit të bankave.
- Të ardhurat e tjera janë planifikuar më të larta se 2024 . Në këtë zë përfshihen të ardhurat nga shitja e biletave të autoparkut, kamatvonesat etj.

B. Planifikimi i Shpenzimeve të Veprimtarisë së EKB-së.

Në planifikimin e zërave kryesor të shpenzimeve është mbajtur parasysh që të përballohen nevojat më të domosdoshme për funksionimin normal të veprimtarisë së EKB-së për gjatë vitit 2025.

Planifikimi i shpenzimeve është kryer duke u mbështetur kryesisht në ecurinë e shpenzimeve në vite si dhe duke pasur parasysh rritjen e cmimeve dhe te pagave. Konkretisht planifikimi i shpenzimeve për Degët Rajonale dhe Drejtorinë e Përgjithshme të vitit 2025, pasqyrohen si më poshtë:

Adresa: Rr. e Kavajës, ndërtesa nr.80, hyrja 1, kati 5, (ish shtëpia botuese Naim Frashëri) Tiranë, Shqipëri Tel: +355 42 227 796, email: info@ekb.gov.al; www.ekb.gov.al

Në Lekë

NR.	Emërtimi	PLANI 2020	PLANI 2021	PLANI 2022	PLANI 2023	PLANI 2024	I PRITSHMI 2024	PLANI 2025
1.	Tiranë	5,029,000	6,099,500	5,997,000	8,227,300	10,326,230	10,127,273	10,109,800
2.	Fier	3,353,000	3,258,300	3,269,000	4,419,750	5,433,755	5,236,364	6,005,600
3.	Durrës	4,948,000	4,977,700	4,973,000	6,114,500	7,315,450	7,072,727	7,934,500
4.	Berat	2,371,000	2,378,200	2,396,000	3,068,900	3,903,280	3,818,182	4,083,900
5.	Korçë	3,353,000	3,351,100	3,325,000	4,571,560	5,503,230	5,349,091	5,911,400
6.	Gjirokastër	2,596,000	3,026,900	3,040,000	4,055,660	5,268,700	5,022,545	5,685,250
7.	Shkodër	3,214,000	3,252,900	3,414,000	4,649,640	5,537,960	5,336,364	5,838,760
8.	Elbasan	3,442,000	3,497,800	3,475,000	4,772,090	5,278,680	4,990,909	5,431,100
9.	Vlorë	3,403,000	3,387,100	3,387,000	4,475,850	5,479,020	5,345,455	6,150,300
10.	Kukës	2,130,000	2,135,100	2,461,000	3,261,500	3,848,420	3,700,000	4,071,400
11.	Dibër	2,355,000	2,386,200	2,295,000	3,052,750	3,731,170	3,502,175	3,975,200
12.	Lezhë	3,543,000	2,431,200	2,711,000	3,261,900	4,123,490	4,063,636	4,050,000
13.	Dr.Përgjithshme	58,163,000	60,218,000	64,173,000	76,470,600	102,124,615	90,272,727	109,824,190
	TOTALI	97,900,000	100,400,000	104,916,000	130,402,000	167,874,000	153,837,448	179,071,400
	Shtesa e struktures							14,213,600
	TOTALI							193,285,000

Më hollësisht programimi i shpenzimeve të veprimtarisë sipas zërave kryesor të tyre për vitin 2025, krahasuar me planet e pesë viteve paraardhëse, dhe të pritshmin 2024 paraqitet si më poshtë:

Lekë

NR.	ZËRAT KRYESOR TË SHPENZIMEVE	PLANI 2020	PLANI 2021	PLANI 2022	PLANI 2023	PLANI 2024	I PRITSHMI 2024	PLANI 2025	shtesa e struktures	Plani 2025 me shtese strukture
1.	Shpenzime administrative	2 174 000	2 225 000	2,277,400	2,600,000	3,523,800	2,987,712	3,390,800		3,390,800
2.	Shpenzime Energji-Ujë	1 459 300	1 306 000	1,385,500	1,456,500	1,592,600	1,101,622	1,313,400		1,313,400
3.	Shpenzime Udhëtime-Dieta	2 070 000	2 116 000	2,205,000	2,209,840	2,019,600	1,362,998	1,470,000		1,470,000
4.	Shpenz Postare-Telefonike	1 132 000	1 120 400	1,189,600	1,140,000	900,000	749,206	877,200		877,200
5.	Komisione Bankare	160 400	183 400	235,000	293,000	293,600	300,000	309,800		309,800
6.	Pagat e Punonjësve	63 445 200	65 267 800	68,476,000	89,026,430	113,553,500	108,049,323	125,070,700	11,751,610	136,822,310
7.	Kontributet Sig. Shoqërore	10 597 600	10 899 800	11,357,000	15,317,360	19,594,800	18,585,299	20,857,692	1,962,510	22,820,202
8.	Shpenzime Tatim Taksa	359 500	957 400	941,300	870,800	1,168,800	1,073,000	879,800		879,800
9.	Shpenzime Pritjeje	50 000	80 000	90,000	100,000	100,000	100,000	200,000		200,000
10.	Shpenzime rojeve autopark	2 100 000	2 100 000	2,205,000	2,174,400	2,900,000	2,641,093	3,534,000		3,534,000
11.	Shpenzime Eksperti Kontabël	1 400 000	1 400 000	1,400,000	1,400,000	1,500,000	1,500,000	1,500,000		1,500,000
12.	Honorare Këshilli Drejtues	2 100 000	2 100 000	2,205,000	2,113,500	3,222,000	3,467,365	4,700,000		4,700,000
13.	Trajnime e Seminare	280 000	120 000	120,000	120,000	200,000	92,000	200,000		200,000
14.	Penalitetet e Gjoha	2 100 000	800 000	800,000	100,000	100,000		-		-
15.	Shpenzime Riparime	1 000 000	1 650 000	1,200,000	1,480,000	2,250,000	1,000,000	1,790,000		1,790,000
16.	Mirëmbajtje e programit , të tjera	240,000	300 000	400,000	200,000	200,000		1,100,000		1,100,000
17.	Shpenzime e Qera zyresh	707 000	1 095 100	1,232,100	1,357,100	1,477,200	1,387,211	1,586,000		1,586,000
18.	Shpenzime Amortizimi	3 991 600	3 748 200	3,850,100	3,862,030	2,936,500	2,936,500	2,218,000		2,218,000
19.	Shpenzime të tjera	859 000	1 955 200	1,362,300	1,761,000	2,831,500	1,447,215	2,157,400		2,157,400
18.	Fondi i pensionit					3,000,000	1,350,000	4,064,608	381,960	4,446,568
19.	Shpenzime 1% të	634 400	652 700	684,700	890,040	1,168,100	1,106,904	1,252,000	117,520	1,369,520
18.	Reklamime , promovime	240 000	120 000	100,000	50,000	1,550,000	1,500,000	200,000		200,000
19.	Shpenzime antarësimi	400 000	400 000	400,000	400,000	400,000	400,000	400,000		400,000
18.	Zbritje akorduar klientëve				680,000	592,000	500,000	-		-
19.	Shpenzime hapje të gjyqeve	2 100 000	800 000	800,000	800,000	800,000	200,000	-		-
	SHUMA	97 900 000	100,400,000	104,916,000	130,402,000	167,874,000	153,837,448	179,071,400	14,213,600	193,285,000

Siç del nga tabela më sipër, shpenzimet e veprimtarisë për vitin 2025 janë programuar 7% më të larta krahasuar me planin e vitit 2024, për shkak të rritjes së pagave për pasojë edhe sigurimeve shoqërore dhe fondit të pensionit, si dhe shpenzime të tjera si mirëmbajtja e programit të kontabilitetit etj.

Krahasuar me të pritshmin 2024, është programuar një rritje prej 16%, kjo për arsyet që renditëm më sipër, por kemi një programim më të lartë se i pritshmi 2024 për fondin i pagave dhe sigurimeve shëndetësore pasi planifikimi është bërë për strukturën e plotë organike, kurse në fakt gjatë vitit 2024 kemi pasur vende vakante për arsye të ndryshme dhe të pa zëvendësuar, pra kemi pasur kursim në këto zëra. Gjithashtu kemi pasur kursim dhe në zëra të tjerë shpenzimesh, që kanë qene të planifikuara për 2024 por të perealizuara. Për vitin 2025, nëse do miratohet shtesa e strukturës, kemi planifikuar një fond shtese për pagat, sigurimet shoqërore etj në nivelin masën 14,214 mijë lekë. Mbështetur në treguesit e programuar të të ardhurave dhe shpenzimeve të veprimtarisë, rezultati financiar i planifikuar për çdo Degë Rajonale të EKB-së dhe për Drejtorinë e Përgjithshme paraqiten si vijon;

REZULTATI FINANCIAR SIPAS DEGEVE 2025

Lekë

Nr	Emertimi	Te ardhura	Shpenzime	Rezultati
1	TIRANE	27,941,200	10,109,800	17,831,401
2	FIER	11,585,000	6,005,600	5,579,400
3	DURRES	41,405,200	7,934,500	33,470,700
4	BERAT	1,324,000	4,083,900	-2,759,900
5	KORCE	7,565,100	5,911,400	1,653,700
6	GJIROKASTER	7,759,000	5,685,250	2,073,750
7	SHKODER	7,240,200	5,838,760	1,401,440
8	ELBASAN	5,448,700	5,431,100	17,600
9	VLORE	34,492,200	6,150,300	28,341,900
10	KUKES	24,719,600	4,071,400	20,648,200
11	DIBER	5,453,700	3,975,200	1,478,500
12	LEZHE	3,336,100	4,050,000	-713,900
13	Dr. PERGJITH	23,400,000	109,824,190	-86,424,190
	TOTALI			


		201,670,000	179,071,400	22,598,600
	Efekti i shteses se struktures		14,213,600	-14,213,600
	Rezultati me shtese strukture	201,670,000	193,285,000	8,385,000

Rezultati financiar për vitin 2025 është parashikuar në vlerën 22,599 mijë lekë, dhe me miratimin e shtesës së strukturës 8,385 mijë lekë. Për vitin 2025 me humbje është planifikuar Dega Berat e cila të ardhurat për këtë vit, i siguron vetëm nga interesat pasi nuk ka në dispozicion apartamente për të shitur ose privatizuar. Në fakt, Dega Rajonale Berat, ka 15 apartamente të trashëguara nga ish-Komunale Banesa dhe të përfunduara nga EKB i cili është në proces legalizimi. Për shkak të procedurave të cilat zgjasin nuk janë parashikuar për tu shitur gjatë 2024. Gjithashtu me humbje është planifikuar Dega Lezhë pasi nuk ka apartamente në dispozicion për të shitur, përveç dy apartamenteve për privatizim, të cilat për shkak të vjetërsisë dhe amortizimit, sigurojnë të ardhura minimale.

Ecuria e Treguesve financiarë në 5 vitet e fundit paraqitet si vijon;

000Lekë

Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	Plani 2021	Fakti 2021	Plani 2022	Fakti 2022	Plani 2023	Fakti 2023	Plani 2024	I pritshmi 2024	Plani 2025	
											pa shtese strukt	me shtese strukt
Të ardhurat	159,853	139,362	155,334	148,752	163,087	218,077	179,672	188,665	199,586	207,092	201,670	201,670
Shpenzimet	102,693	92,912	100,400	94,238	104,916	92,314	130,402	122,556	167,874	153,837	179,071	193,285
Rezultati Financiar	57,160	46,450	54,934	54,513	58,171	125,762	49,270	66,109	31,712	53,254	22,599	8,385



Rezervat dhe Risqet

Adresa: Rr. e Kavajës, ndërtesa nr.80, hyrja 1, kati 5, (ish shtëpia botuese Naim Frashëri) Tiranë, Shqipëri Tel: +355 42 227 796, email: info@ekb.gov.al; www.ekb.gov.al

1. Në programin ekonomik dhe financiar të vitit 2025, janë planifikuar të ardhura nga lidhja e rreth 242 kontrata të reja në banesat e ndërtuara me fondet e veta të EKB-së, nga të cilat, Vlorë 75 ap., Has 35, Shkodër 4, Delvina 29, Rroskoveci 29, dhe privatizime nga të cilat Tirana 32, Durrësi 26, Korça 4, Shkodra 6 dhe Lezha 2.

Mbështetur në analizën e kostos së ndërtimit të banesave, analizës së çmimeve të shitjes të apartamenteve dhe gjëndjes ekonomike të banorëve të bashkive, rezulton se propabiliteti dhe impakti i riskut vlerësohet i ulët dhe nuk ka efekt financiar në mos realizimin e të ardhurave, duke marrë parasysh shitjen e menjëhershme në banesat e përfunduara, Gramsh, Maliq dhe Kukës (përfunduar rastin e 2 banesave të para të Vlorës shitja e së cilës u realizua me vonesë jo për shkak të mungesës së interesit nga qytetarët por për shkak të paparashikuara).

Kurse duke marrë shkas nga realizimi dhe ecuria e investimeve në dy vitet e fundit, mospërfundimi sipas parashikimeve i banesave të reja, impakton një risk të lartë, pasi mos përfundimi në kohë sjell edhe mosrealizimin e shitjeve dhe për pasojë mosrealizimin e të ardhurave si dhe të arketimeve të menjëhershme në momentin e lidhjes së kontratës 5% & 10%. Kjo duke marrë shkas nga mosrealizimi i planit të shitjes gjatë vitit 2024 për shkak të mospërfundimit të banesave në Has, Vlorë, dhe Delvinë.

- *Këtu vlen të përmendim objektin në Has, i cili duhet të përfundonte para 3 vjetësh dhe është planifikuar cdo vit pas afatit të përfundimit për tu shitur, por për shkak të problemeve të paraqitura nuk është realizuar. Edhe për këtë vit përbën risk të lartë nëse nuk dorëzohet objekti. Kjo impakton një mosrealizim prej rreth 6 milion leke të ardhura.*
- *Gjatë vitit 2024 duhet të kishte përfunduar dhe shitur 2 banesat në Vlorë, të cilat nuk janë dorëzuar. Janë planifikuar për tu shitur gjatë vitit 2025. Mospërfundimi në kohë do të impaktonte një mosrealizim të të ardhurave prej rreth 27 milion lekë.*
- *Gjithashtu gjatë vitit 2024 duhet të kishin përfunduar dhe shitur banesa në Delvinë. Është planifikuar për tu shitur në vitin 2025. Mospërfundimi gjatë këtij viti do të sillte mos realizim të të ardhurave prej rreth 7 milion lekë.*
- *Banesa e Rroskovecit ka qënë e planifikuar për të përfunduar në fund të vitit 2024 dhe për këtë arsye nuk ka qënë planifikuar për tu shitur në këtë vit. Është planifikuar për tu shitur në vitin 2025. Mosrealizimi i përfundimit do të sillte mosrealizim të të ardhurave prej rreth 7 milion lekë.*

2. Plotësimi i planit të të ardhurave nga shitja e shitja e 19 njësi të shërbimit dhe 44 garazheve të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së, nëpërmjet ankandeve të njësi të shërbimit dhe garazheve, nga të cilat: 3 njësi shërbimi në Fier, 3 garazhe në Korçë, 8 garazhe në Maliq, 11 garazhe dhe 6 njësi shërbimi në Burrel, 2 njësi shërbimi në Kukës, 22 garazhe dhe 8 njësi në Vlorë mund të reduktohet për mungesë ofertash nga subjektet e interesuara, dhe paraqet risk duke parë ecurinë e shitjeve gjatë dy viteve të fundit.

3. Planifikimi i të ardhurave nga 4% & 5%, të cilat janë të lidhura me shitjen e apartamenteve si dhe nga privatizimet me VKM, paraqet risk për mos realizim për të njëjtat shkaqe që përmendëm në realizimin e të ardhurave nga shitja.

4. Gjithashtu, realizimi i të ardhurave nga interesat e kontratave, impaktohet nga mospërfundimi në kohë i investimeve, pasi janë parashikuar rritje klientesh nga shitja e apartamenteve të reja.

5. Planifikimi i arkëtimeve nga shitja, është bërë mbi bazën e detyrimeve që kanë klientët për pagesat e kësteve mujore dhe vjetore, si dhe është mbajtur në konsideratë ndjekja ritmike e arkëtimeve nga këstet e planifikuara të kredive dhe të interesave të kontratave, duke zbatuar procedurat e Manualit “Politikave dhe Procedurat e Menaxhimit të Debitorëve”.

Për këtë do kryejmë analizat përkatëse në bashkëpunim me degët do të marrim masat përkatëse për debitorët duke zbatuar kërkesat e manualit mbi menaxhimin e debitorëve, duke u dhënë mundësitë e lidhjes së akt-marrëveshjeve përkatëse, ose për debitorët që nuk ofrojnë mundësi pagese do të ndërmerren hapat ligjore nëpërmjet proceseve gjyqësore. Nisur nga eksperiencat e mëparëshme, gjatë vitit pakësohen një numër debitorësh më të lartë se sa krijohen të rinj gjatë vitit dhe gjendja e detyrimeve të debitorëve vjen në ulje nga viti në vit, dhe do të përpiqemi të minimizojmë riskun për realizimin e planit të arkëtimeve.

Realizimi i arkëtimeve sidomos në zërin arkëtime nga 5% dhe 10%, paraqiten me risk për mosrealizim pasi janë të lidhura ngusht me realizimin e shitjeve.

6. Programimi i investimeve ndërtimore për vitin 2025 është në shumën 1,366 milion lekë për ndërtimin e 9 banesave të reja me kosto të ulët nga të cilat 1 banesë e tenderuar në Shijak, 6 banesa (Shkodër, Berat, Lushnje, Korçë, Burrel dhe Peshkopi) janë miratuar nga Këshilli Drejtues gjatë vitit 2024, dhe 2 banesa të tjera (Librazhd dhe Gramsh) që mund të miratohen gjatë vitit në vazhdim pasi të kryehen analizat e riskut .

Informojmë se për çdo banesë në ndërtim dhe të miratuara në KD është bërë më parë analiza teknike e ndërtimit dhe e riskut , dhe nuk parashikohet risk lidhur me fondet e financimit të cilat janë nga burimet e veta të EKB-së. (Banesa e Peshkopisë është planifikuar të ndërtohet pjesërisht me fondet e EKB dhe pjesërisht me fondet e MEKI-t). Për këtë, nga Drejtoria Ekonomike, është bërë parashikimi i Cash Floë-t për vitin 2025, ku rezulton se niveli i gjendjes së arkëtimeve dhe fondeve të depozitave mund të përballojnë financimin e investimeve në proces dhe të shpenzimeve të aktivitetit të EKB-së për vitin 2025, por në fund të vitit 2026 parashikojmë që të mbeten likuiditete të lira dhe në depozitat bankare rreth **195 milion lekë**, i cili është parashikuar në kushtet e realizimit të plotë të shitjeve sidomos në banesat e reja, dhe arkëtimin e 5% dhe 10% në mënyrë të menjëhershme.

Më konkretisht Parashikimi i Cash Floë-t për vitet 2024-2028 paraqitet si vijon;


000 Leke

Nr	Emertimi	Parashiki mi Cash Floë Dhjet 2024	Parashiki mi Cash Floë 2025	Parashiki mi Cash Floë 2026	Parashikimi i Cash Floë 2027	Parashikimi Cash Floë 2028
I	Gjendje likuiditete fillim	855,000	857,800	638,139	194,271	209,074
a-	Llogari rrjedhese	205,000	207,800	138,139	94,271	89,074
b-	Depozite	650,000	650,000	500,000	100,000	120,000
II	ARKETIMET	22,800	480,176	377,000	470,800	446,360
1	Arketimet nga Principali	15,000	187,336	210,000	225,000	240,000
2	Arketime nga interesat	4,000	52,816	70,000	90,000	100,000
3	Arketime nga kamatvonesat	300	2,715	3,000	3,000	3,000
4	Arkëtime nga pagesat e menjëhershme(10%, 4%, 5%,etj)		139,309	80,000	150,000	100,000
5	Arketime nga fondet e MEKI		80,000			
6	Interesat depozitave	3,500	18,000	14,000	2,800	3,360
	Shuma	22,800	480,176	377,000	470,800	446,360
III	PAGESAT	20,000	699,836	820,868	455,997	255,922
A	Investime banesa ne qytetet;					
1	HAS	0	9,846	0	5,930	0
2	VLORA 2	0	42,306	0	10,196	0
3	DELVINE	0	17,737	0	4,105	0
4	ROSKOVEC	0	17,036	0	4,388	0
5	SHIJAK	0	48,612	44,467	0	4,541
6	SHKODER	0	31,167	75,879	32,722	6,961
7	KORÇE	0	31,867	73,638	59,145	8,125
8	PESHKOPI	0	61,063	52,936	22,922	6,903
9	LUSHNJE	0	60,500	74,792	4,504	6,961
10	BERAT	0	61,867	73,638	28,422	8,125
11	BURRELI 2	0	30,367	102,418	3,621	6,903
12	LIBRAXHD	0	61,367	61,108	25,189	7,309
	GRAMSH	0	35,806	73,430	63,289	8,531

Adresa: Rr. e Kavajës, ndërtesa nr.80, hyrja 1, kati 5, (ish shtëpia botuese Naim Frashëri) Tiranë, Shqipëri Tel: +355 42 227 796, email: info@ekb.gov.al; www.ekb.gov.al

13						
	Shuma	-	509,542	632,305	264,434	64,359
B	Investime të tjera					
1	Blerje mobiliere dhe orendi zyresh		313	313	313	313
2	Blerje pajisje elektronike		1,731	1,000	1,000	1,000
3	Blerje kondicionerësh		250	250	250	250
	Shuma	-	2,294	1,563	1,563	1,563
C	Shpenzime të tjera		-			
1	Shpenzime operative	20,000	178,000	180,000	180,000	180,000
	Tatim Fitimi		10,000	7,000	10,000	10,000
	Shuma	20,000	188,000	187,000	190,000	190,000
D	Gjendja e likuiditeteve ne fund	857,800	638,139	194,271	209,074	399,512
a-	Llogari rrjedhese	207,800	138,139	94,271	89,074	99,512
b-	Depozite	650,000	500,000	100,000	120,000	300,000
2	Totali i Hyrjeve	22,800	480,176	377,000	470,800	446,360
3	Totali i Daljeve	20,000	699,836	820,868	455,997	255,922
	Diferenca	2,800	-219,661	-443,868	14,803	190,438

PARASHIKIMI I CASH FLOW 2024-2028



PLANIFIKIMI DHE DETAJIMI I PLANIT TË INVESTIMEVE NDËRTIMORE PËR VITIN 2025.

Në kuadër të zbatimit të politikave të strehimit, për përmirësimin e kushteve të strehimit si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.22/2018 “ Për strehimin social” i ndryshuar, u kemi derguar kërkesë për bashkëpunim të gjitha Bashkive të vendit. Shumë nga Bashkitë kanë shprehur zyrtarisht interes për ndërtimin e banesave me kosto të ulët (BKU) dhe efikasë energjie.

Kanë shprehur interes 12 Bashki, si ajo : Berat, Burrel, Tropojë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Durrës, Shijak (miratuar nga viti 2023), Lushnje, Korçë, Elbasan, Librazhd, Gramsh, Gjirokastrë, Dibër.

Për vitin 2025, parashikimi i investimeve është hartuar vetëm me ato Bashki që kanë ofruar sheshe ndërtimi me pronësi në favor të EKB- së. Aktualisht Enti Kombëtar i Banesave ka siguruar sheshe ndërtimi në qytetin e Shijakut, Burreli II, Beratit, Lushnjes dhe është në proces njohje me karakteristikat e shesheve të ofruara nga Bashkitë e tjera që janë angazhuar të bashkëpunojnë duke siguruar sheshe ndërtimi me kondicione urbane optimale.

Në disa Bashki, si Shkodër, Korçë, Dibër, për të cilat është miratuar ndërtimi i banesave në Këshillin Drejtues, po vijon puna për realizimin e të gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor të nevojshëm për nisjen e investimeve.

Për vitin 2025 objektivi ynë në fushën e investimeve do të jetë:

- a. Përfundimi i banesave të nisura në qytetet Vlorë (Vlorë II), Has, Delvinë.
- b. Marrja në dorëzim e banesës 6 kat në qytetin e Roskovecit/ marrja e certifikatës së pronësisë.
- c. Fillimi i ndërtimit të banesës 6 kat me një kat parkim nëntokë në qytetin Shijakut.
- d. Vijimi i procedurave për fillimin e ndërtimit të banesave në qytetet Berat, Lushnje, Korçë.
- e. Zgjerimin e bashkëpunimit të EKB-së me organet e vetëqeverisjes vendore, për sigurimin e shesheve të ndërtimit për ndërtimin e banesave me kosto të ulët për strehimin e familjeve të pastreha sikurse është kërkuar nga Bashkitë Tropojë(Tropoja 2), Gjirokastra, Elbasan, Librazhd, Gramsh, Dibër, Kukës, Lezhë, Shkodër, Durrës.

Më poshtë po paraqesim parashikimi dhe detajimi e “ Planit të Investimeve Ndërtimore për vitin 2025, vetëm për shpenzimet e kontratave të sipërmarrjes, mbikëqyrjes, etj.

Nr.	Emërtimi objektit	Vlera e investimeve parashikuara per Vitin 2025
A	Investime të miratuara gjate vitit 2024	925,447,282
1	Banesë 8kat dhe një kat parkimi nën tokë në qytetin e Beratit	172,051,930
*	Ndërtim banese 8kat	162,500,000
*	Mbikëqyrje punimesh	1,500,000
*	Projekt mirëmbajtje	60,000
*	Performanca e Energjisë faza I	1,500,000
*	Performanca e Energjisë faza I	1,500,000
*	Kolaudim objekti	350,000
*	Sigurim objekti	1,625,000
*	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ.	2,400,000
*	Të tjera (ruajtje objekti, etj).	616,930
2	Banesë 6kat dhe një kat parkimi nën tokë në qytetin e Burrelit Nr. 2	143,310,000
*	Ndërtim banese 6kat	138,069,172
*	Mbikëqyrje Punimesh	1,000,000
*	Projekt mirëmbajtjeje	60,000
*	Performanca e Energjisë faza I	620,000
*	Performanca e Energjisë faza II	620,000
*	Kolaudim objekti	287,500
*	Sigurim objekti	1,100,000
	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ	1,553,328
3	Banesë 6kat dhe një kat parkimi nën tokë në qytetin e Lushnjes	146,757,090
*	Ndërtim banese 6kat	139,215,090
*	Mbikëqyrje Punimesh	1,437,500
*	Projekt mirëmbajtjeje	800,000
*	Performanca e Energjisë faza I	800,000
*	Performanca e Energjisë faza II	287,500
*	Kolaudim objekti	1,392,151
*	Sigurim objekti	90,000
	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ	1,734,849

*	Të tjera (ruajtje objekti, etj)	1,000,000
4	Banesë 6kat dhe një kat parkimi nën tokë në qytetin e Shkodres	146,729,090
*	Ndërtim banese 6kat	139,215,090
*	Mbikëqyrje Punimesh	1,380,000
*	Projekt mirëmbajtjeje	60,000
*	Performanca e Energjisë faza I	800,000
*	Performanca e Energjisë faza II	800,000
*	Kolaudim objekti	287,500
*	Sigurim objekti	1,127,000
*	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ	1,900,000
*	Të tjera (ruajtje objekti, etj)	1,159,500
5	Banesë 8kat dhe një kat parkimi nën tokë në qytetin e Korçës	172,775,000
*	Ndërtim banese 8kat	162,500,000
*	Mbikëqyrje punimesh	1,500,000
*	Projekt mirëmbajtje	60,000
*	Performanca e Energjisë faza I	1,500,000
*	Performanca e Energjisë faza I	1,500,000
*	Kolaudim objekti	350,000
*	Sigurim objekti	1,625,000
*	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ., Tropojë nr. 2	2,400,000
*	Të tjera (ruajtje objekti, etj).	1,340,000
6	Objekti, Peshkopi 6kat	143,824,172
*	Ndërtim banese 6kat	138,069,172

*	Mbikëqyrje Punimesh	1,100,000
*	Projekt mirëmbajtjeje	50,000
*	Performanca e Energjisë faza I	600,000
*	Performanca e Energjisë faza II	600,000
*	Kolaudim objekti	105,000
*	Sigurim objekti	1,100,000
*	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ	2,200,000
B	INVESTIME PER VITIN 2025	336,029,103
1	Banesë 8kat dhe një kat parkimi nën tokë në qytetin e Gramshit	181,056,250
*	Ndërtim banese 8kat	170,625,000
*	Mbikëqyrje punimesh	1,575,000
*	Projekt mirëmbajtje	60,000
*	Performanca e Energjisë faza I	1,500,000
*	Performanca e Energjisë faza I	1,500,000
*	Kolaudim objekti	350,000
*	Sigurim objekti	1,706,250
*	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ.	2,240,000
*	Të tjera (ruajtje objekti, etj).	1,500,000
2	Banesë 6kat dhe një kat parkimi nën tokë në qytetin e Librazhdit	154,972,853
*	Ndërtim banese 6kat	146,175,845
*	Mbikëqyrje Punimesh	1,475,250

	Projekt mirëmbajtjeje	60,000
*	Performanca e Energjisë faza I	1,000,000
*	Performanca e Energjisë faza II	1,000,000
*	Kolaudim objekti	300,000
*	Sigurim objekti	1,461,758
*	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ	2,000,000
*	Të tjera (ruajtje objekti, etj)	1,500,000
	TOTAL INVESTIME TE REJA (A+B)	1,261,476,385
C	Investime të mbartur nga viti 2020-2021-2022-2023	190,937,832
1	Banesë 8kat banim dhe shërbim dhe një kat nëntokë në qytetin e Hasit	7,195,725
*	Ndërtim Objekti Has	3,951,344
*	Mbikëqyrje Punimesh.Objekti Has	86,285
*	Kolaudim objekti Has	108,096
*	Sigurim objekti, Has	1,250,000
*	Regjistrim ASHK	1,200,000
*	Pagesa e rojeve, Energji elektrike, etj.	600,000
2	Objekti Vlorë 2	44,001,846
*	Ndërtim për 2 banesave, në Vlorë 2	34,092,881
*	Mbikëqyrje për 2 banesa, në Vlorë 2	938,965
*	Projekt mirëmbajtje për 2 banesa, në Vlorë 2	120,000
*	Performanca e Energjisë faza II, 2 banesa Vlorë 2	2,400,000
*	Kolaudim objekti 2 banesa	250,000

*	Sigurim objekti 2 banesa	2,100,000
*	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ, 2 banesa.	2,600,000
*	Të tjera (ruajtje objekti, etj.)	1,500,000
3	Ndërtim objekt banimi dhe shërbimi 6kat në qytetin e Shijakut	97,548,682
*	Ndërtim banese 6kat	90,817,943
*	Mbikëqyrje Punimesh	1,012,560
*	Projekt mirëmbajtje	60,000
*	Performanca e Energjisë faza II	800,000
*	Kolaudim objekti	250,000
*	Sigurim objekti	908,179
*	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ.	2,200,000
*	Të tjera (ruajtje objekti, etj.)	1,500,000
4	Banesë 6kat në qytetin e Delvinës	18,342,309
*	Ndërtim banese 6kat	12,008,887
*	Mbikëqyrje Punimesh	703,422
*	Projekt mirëmbajtje	60,000
*	Performanca e Energjisë faza II	800,000
*	Kolaudim objekti	250,000
*	Sigurim objekti	820,000
*	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ, Objekti Delvinë	2,200,000
*	Të tjera (ruajtje objekti, etj.)	1,500,000
5	Banesë 6kat në qytetin e Roskovecit	23,849,270
*	Ndërtim banese 6kat	17,924,166

*	Mbikëqyrje Punimesh	215,104
*	Projekt mirëmbajtje	60,000
*	Performanca e Energjisë faza II	800,000
*	Kolaudim objekti	250,000
*	Sigurim objekti	900,000
*	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ.	2,200,000
*	Të tjera (ruajtje objekti, etj.)	1,500,000
D	Studime-projektme (230) për VNM, studime zizmike & gjeologjik, rievime, raporte ekspertize, rishikim detajesh të të projekteve, përshtetje e kuotës 00 etj., të objekteve të parashikuara për periudhën 2023-2024.	5,000,000
*	SHUMA	1,457,412,217

Për vitin 2025 janë planifikuar kryerja e investimeve për ndërtimin e objekteve sipas të dhënave të tabelës si më sipër në shumën prej 1364025067 lekë me TVSH, e ndarë si:

- Në shumën 190,937,832 lekë me TVSH për financimin e investimeve të mbartura nga viti 2020,2021, 2022,2023.
- Në shumën 925,447,287 lekë me TVSH për financimin e investimeve të miratuara nga viti 2024.
- Në shumën 336,029.,103 lekë me TVSH për financimin e investimeve te reja të vitit 2025.
- Në shumën 5,000,000 lekë me TVSH për financimin e Studim -Projektme te reja apo te Marreveshjes Kuader.

Më poshtë jepen disa sqarime lidhur me investimet e mbartura apo në vazhdimësi si dhe ato të planifikuara për vitin 2025:

1. Objekti: Banese 8 kate me një kat shërbimi dhe me një kat parkim nën tokë në qytetin e Hasit (35 apartamente).

Sipërmarrës për këtë objekt është BOE “LALA” sh.p.k. & “Gjukuria” sh.p.k .

Kontrata me Nr 1031/2prot., datë 05.10.2020.

Afati i kontratës 300 ditë kalendarike.

Punimet në këtë objekt kanë filluar në datën 12.10.2020

Afati i përfundimit të punimeve 08.12.2021

Vlera e kontratës 122,580,181 leke me tvsh.

Vlera e punimeve fakti (situacioneve te likujduara) është 118,623,460 leke me tvsh. Vlera e likujdimeve të mbetura 3, 956, 721 lekë me tvsh.

Aktualisht në objekt kanë përfunduar punimet ndërtimore në masën 100 %. Njoftimi për përfundimin e punimeve i paraqitur nga Mbikëqyrësi i punimeve, shoqëria “ G B Civil Engineering “ shpk., është nr.82 prot, datë 02.05.2024. Periudha mbas njoftimit për përfundimin e punimeve shërben për përgatitjen e dosjes teknike të objektit. Mbas miratimit të dosjes me të gjitha dokumentat ligjore e teknike prej Mbikëqyrësit, ne si Autoritet Kontraktor vijojmë me aplikime për të paisur objektin me lejen e shfrytëzimit dhe me tej me aplikimet për titujt e pronësisë dhe lidhjen e kontratave me përfituesit. Në mënyrë të përsëritur, me anë të shkresave por dhe verbalisht BOE “LALA” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k. i është kërkuar dorëzimi zyrtar i dosjeve teknike. Pretendimi i tyre shkresor na tregon se ka të bëjë me kushtin se dokumentatat teknike i dorëzon po të bëjmë likujdimin e mbajtur nga ana jonë. *Po e citojmë më poshtë si në shkresën nr.78, datë 11.11.2024, “ Kërkesë mbi detyrimet Kontraktuale” ku shprehen si më poshtë: “ Ju garantojmë me përgjegjësi të plot ligjore se me gjithë vështirësitë e krijuara objekti është përfunduar nga ana jone ne përputhje te plot me kushtet teknike te projektimit dhe kushtet teknike të zbatimit.*

Ju lutem te beni urgjentisht pagesen e mbajtur padrejtësisht nga ana juaj si dhe miratimin e punimeve shtesë, që të mbyllet dhe dokumentacioni i plotë teknik”.

Ndaj shoqërisë sipërmarrëse, për tejkallim të afateve (grafikut të punimeve) janë vendosur penalitete në përputhje me dispozitat e udhëzimet ligjore, sipas kushteve të kontratës “ Dëshmërimi për shkelje të afateve të kontratës”.

Për ne si AK vonesat ne dorëzimin e objektit janë te pa justifikueshme. Objekti ka përfunduar nga ana ndërtimore, por dorëzimi i dokumentacionit teknik i objektit nuk është plotësuar. Vonesa ne dorëzimin e dokumentacionit na pengon ne kolaudimin e punimeve dhe marrjen ne dorëzim te objektit. Pretendimi zyrtar i kontraktorit “ Lala “ shpk, me administrator z.Jonuz Lala, është mbajtja e penaliteteve ne shkelje te afateve te zbatimit te kontrates. Sqarojme se penalitetet i janë mbajtur deri ne momentin e hyrjes ne fuqi te Aktit Normativ nr.10. Jemi duke përgatitur rruge te tjera juridike e ligjore per zgjidhjen e mosmarrveshjeve me kete subjekt.

2. Objekti: Dy banesa 8 kat me 1 kat nën tokë, nga këto njëra me ambiente shërbimi në katin përdhe në qytetin e Vlorës (Vlora II) 75 apartamente.

Sipërmarrës për këtë objekt është BOE “ED KONSTRUKSION” sh.p.k & “NDËRTIMI” sh.p.k & “COLOMBO” sh.p.k

Kontrata me me Nr.2073/3 prot, datë 24.02.2021,

Afati i kontratës 400 ditë kalendarike.

Punimet në këtë objekt kanë filluar në datën 11.03.2021

Afati i përfundimit të punimeve 15.03. 2024

Vlera e kontratës 203,924,767 leke me tvsh.

Vlera e punimeve fakti (situacioneve te likujduara) është 169, 831,886 leke me tvsh.

Vlera e likujdimeve të mbetura 34, 092,881 lekë me tvsh.

Realizimi i punimeve është rreth 94%.

Likujdimi i punimeve 169, 831,886 leke me tvsh., ose 83 % e vlerës së kontratës.

Aktualisht ky objekt është në shkelje të afateve të kontratës. Për periudhën nga 15 Mars 2024 që ish parashikuar perfundimi i punimeve deri në dorezimin e plot të punimeve drejtuesit e sipërmarrësit janë njoftuar se janë me penalitete, sipas kushteve të kontratës sipas kushteve të kontratës “Dëshmëpërblimi për shkelje të afateve të kontratës”. Punime të mbetura pa realizuar janë si: furnizimi dhe vendosja e ashensorit, MNZ, furnizimi dhe vendosja e veturave të katit me njësi shërbimi, furnizimi me ujë, furnizimi me energji, pjesërisht dyer e dritare dhe sistemimet e jashtme të terrenit. Puna në objekt është ndërprerë në muajin Mars 2024, me justifikimin se kërkojnë miratimin e ndryshimeve sasiore në disa zëra punimesh që kanë ardhur si rezultat i mosperputhjes së preventivit me projektin dhe me faktin, për të cilat në kemi kryer llogaritjet tona dhe nuk kemi qene dakord me llogaritjet e tyre. Kemi vijur disa herë ballafaqimin e volumeve me specialist të Kontraktorit por nuk kemi gjetur dakortësi. Për volumet e propozuara për miratim mungon dokumentacioni teknik justifikues si librezë e masave e firmosur nga sipërmarrësi dhe miratuar nga mbikqyrësi i punimeve, foto, skicat, proces verbale të mbajtura nga sipërmarrësi dhe mbikqyrësi për volumet shtesë. Theksojmë se në datë 11.10.2024 i kemi nisur shkresën nr.1316/2 prot, ku i kemi kërkuar që mosmarrvehjet tona duhet të zgjidheshin kundrejt nenit nr.41, pika 1 dhe pika 2 të kontratës nr.2073 prot, datë 24.02.2021, të cilat u ezauruan dhe nuk dhanë rezultat. Në këto kushte u kemi sygjëruar se mund të propozoni ekspert ose grup ekspertësh ku secila palë të paraqes ekspertët e vet dhe eksperti i tret të pranohet nga të dy palët. Eksperti i tretë është inxhinierja e ndërtimit Luiza Bala. Brenda datës 25 Nëntor 2024.

Vonesat për mos mbylljen e tij në kohë, ka çuar në mosrealizimin e planit të investimeve.

Për këtë investim EKB ka si objektiv marrjen e masave dhe të ndjekë me prioritet çdo problematikë të lindur në mënyrë që ky objekt të arrijë të përfundojë sa më parë.

3. Objekti: Banesë 6 kat në qytetin e Delvinës – Bashkia Delvinë (29 apartamente)

Sipërmarrës për këtë objekt është BOE “ED-Konstruksion” shpk & “Viante” shpk.

Kontrata me me Nr.2073/3 prot, datë 24.02.2021,

Afati i kontratës 480 ditë kalendarike.

Punimet në këtë objekt kanë filluar në datën 15.01.2022.

Afati i përfundimit të punimeve 10.04.2024.

Vlera e kontratës 82,106,261 leke me tvsh.

Vlera e punimeve fakti (situacioneve të likujduara) është 70,097,378 lekë me tvsh.

Vlera e likujdimeve të mbetura 12,008,887 lekë me tvsh, ose 85.4 %.

Realizimi i punimeve është rreth 100 %.

Referuar kontratës dhe amendimeve, punimet në objekt duhet të kishin përfunduar në datë 10.04.2024, nga ana e sipërmarrësit të punimeve BOE “ED-Konstruksion” shpk & “Viante” shpk është sjellë njoftim përfundim punimesh, por jo i konfirmuar nga ana e Mbikëqyrësit. Nga ana e

EKB-së janë bërë njoftimet zyrtare se objekti do të ketë penalitete për vonesat në afat. Punimet për furnizimin me uje dhe energji dhe shkarkimin e ujrave të zeza janë duke përgatit dokumentacionin për miratim të pikave të lidhjes nga entet perkatese.

Për subjektin në fjalë do të aplikohen penalitete “ Dëmshtëpërblimi për shkelje të afateve të kontratës”.

Nga ana jonë do të vazhdojmë me kolaudimin e punimeve të ndërtimit, regjistrimin e apartamenteve në ASHK, dhe lidhja e kontratave të shitjes me përfituesit në Delvinë.

4. Objekti: Banesë dhe shërbime 6k me një kat nën tokë në qytetin e Burrelit- Bashkia Mat. (25 apartamente)

Kanë përfunduar punimet ndërtimore komplet. Objekti është ven në shfrytëzim. Janë lidhur në muajin Tetor 2024, të gjitha kontratat, gjithsej 25 përfitues. Objekti është në periudhën e garancisë së punimeve deri në një vit kalendarik.

Objekti: Banesë 6k në qytetin e Roskovecit – Bashkia Roskovec (25 apartamente)

Sipërmarrës për këtë objekt është shoqëria “ Shëndelli ” shpk.

Kontrata me Nr.108/1prot, datë 06.06.2023

Afati i kontratës 480 ditë kalendarike.

Punimet në këtë objekt kanë filluar në datën 06.06.2023

Afati i përfundimit të punimeve 25.11.2024.

Vlera e kontratës 87,764, 918 leke me tvsh.

Vlera e punimeve fakti (situacioneve të likujduara) është 69,840, 752 lekë me tvsh ose 79.6 %.

Vlera e likujdimeve të mbetura 17,924, 166 lekë me tvsh.

Mbikëqyrësi i punimeve është shoqëria “ G B Civil Engineering “ shpk.

Realizimi i punimeve në volum është rreth 97 %.

Sipas grafikut të punimeve të miratuara dhe situatës faktike të punimeve të kryera, ky objekt do të realizohet në afat.

5. Godine Banimi dhe shërbime 6k në qytetin e Shijakut–Bashkia Shijak (25 apartamente)

Sipërmarrës për këtë objekt është shoqëria “ Kevin Konstruksion ” shpk.

Vlera e kontratës pa tvsh, 76, 263, 018 lekë

Vlera e kontratës me tvsh 90, 817, 943 lekë.

Afati i realizimit të punimeve 480 ditë kalendarike nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit.

Mbikëqyrësi i punimeve me kontratë shërbimi për mbikëqyrjen e punimeve Nr. 788, datë 31.03.2023, është shoqëria “ Firmitas Studio” shpk & “ Net- Grup ” shpk.

Vlera e kontratës së mbikëqyrjes me tvsh 1, 012, 560 lekë.

Të dhëna të tjera për lejën e ndërtimit:

*Leje zhvillimi nga Bashkia Shijak nr.6686 prot, datë 16.11.2021, “ Vendim “ nr.744 datë 16.11.2021

*Aplikimi nga EKB-ve për leje ndërtimi është bërë më datë 17.11.2022.

*Kemi marë, miratimin nga Bashkia Shijak, me shkresë nr.4105/1 prot, datë 30.10.2024., lejen e ndertimit nr.3924/1 prot, datë 20.09.2024,” Vendim “ nr. 256, datë 20.09.2024.

*Me shkresë nr 1383/2 prot, datë 01.11.2024 të EKB i kemi venë në dispozicion “ Kevin Konstruksion ” shpk. lejen e ndërtimit (e korrigjuar) dhe i kemi kërkuar marrjen e masave për ngritjen e kantjerit, me qëllim fillimin e zbatimit të punimeve.

Shoqëria “ Kevin Konstruksion “ shpk, me anë të shkresës nr.156 prot, datë 04.11.2024 (e jona nr.1383/4 prot, date 06.11.2024) kërkon ndryshimin e “ Çmimit të kontratës” së nënshkruar. Për ndryshimin e “ Çmimit të kontratës” argumentimi i tyre i referohet çmimeve të ofruara në preventivin e shpallur fitues se këto çmime i janë referuar çmimeve të “ Manuali Teknik i Çmimeve të Ndërtimit“ i vitit 2015, i çfuqizuar. Dhe se çmimet e materialeve të ndërtimit, paga minimale e punonjësve, janë rritur.

Ky pretendim i “ Kevin Konstruksion “ shpk, mund të jetë i drejtë e ligjor, referuar kontrates, nenit 47 “ Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve”. Por ne si AK në hartimin e kontratës i referohemi Ligjit nr. 162 , date 23.12.2020 “ Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr.285, datë “ Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, kjo shprehur në njoftimin e shpalljes së kontrates me anë të DST.

Në DST, te kushtet e përgjithshme të kontratës: Neni 7 , “ Çmimi i kontratës”

“Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në nenin 24 DST ”.

Referuar nenit 98, pika 3, e LPP, Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj vendimarrjes së tyre për ofertat.

Me arsyetimin e paraqitur nga sipërmarrësi “ Kevin Konstruksion “ shpk, AK nuk mund të bëjë ndryshimin e çmimit të kontratës së nënshkruar, pasi në kreun XV “ Zbatimi i kontratave” , neni 127 pika 4/a, “ Modifikimi i Kontratave gjatë afatit të tyre “ , “ Modifikimi sjell kushte, të cilat në rast se do të kishin qenë pjese e procedurës fillestare të prokurimit, do të kishin lejuar pjesmarrjen e kandidatëve të tjerë, përveç atyre që ishin ftuar, ose pranimin e ndonjë oferte tjetër, si ekonomikisht më e favorshme nga ajo e përzgjedhur fillimisht, ose do të kishin lejuar pjesmarrjen e kandidatëve shtesë në procedurën përkatëse të prokurimit publik”.

Me marrjen e njoftimit për ngritjen e kantjerit dhe vendosjen e tabelës informuese nga sipërmarrësi

“ Kevin Konstruksion “ shpk, duhet të vijojë me nënshkrimin e aktit të dorëzimit të sheshit të ndërtimit dhe aktin e piketimit, fillimin e punimeve, etj, në përmbajtje të përcaktimeve ligjore.

Ne lidhje me investimet e reja te miratuara ne programin ekonomik te vitit 2024 kemi shume pengesa ne zbatimin e marrveshjeve respektive, si me poshte:

Bashkia Shkoder nuk ka ndermare akoma asnje hap ne sigurimin dhe venien ne dispozicion te sheshit te ndertimit. Eshte shume ne vonese ne transferimin e truallit te ndertimit. Ky investim nuk mund te kap afatet kohore per vitin 2024.

Bashkia Berat, është në procesin e transferimit të truallit në favor të EKB, por procesi i çregjistrimit dhe transferimi varet nga ASHK. Me marrjen e çertifikates së pronësive EKB do të realizojë përgatitjen e dokumentacionit për procedurat e tenderit. Ky objekt nuk mund të shpallet në sistem brenda vitit 2024, pasi e gjithë procedura shkon deri në 60 ditë.

Bashkia Korçë, nuk ka ndermarrë akoma asnjë hap në sigurimin dhe venien në dispozicion të sheshit të ndërtimit. Është shumë në vonesë në transferimin e truallit të ndërtimit. Për vitin 2024 ky investim nuk mund të kap afatet kohore.

Bashkia Lushnje,

Kemi aplikuar për leje zhvillimore. Bashkia Lushnje është në procese të sistemit të dokumentacionit të pronësive mbi truallin, shkak një rekomandim i KLSH i vitit 2019 në këtë Bashki, për truallin që do të ndërtohet, saktësim të pronësive. Për vitin 2024 ky investim nuk mund të kap afatet kohore.

Bashkia Mat,

Bashkia Mat për ndërtimin e banesës 6 kate nr.2 **ka miratuar lejen zhvillimore**. ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit mes palëve. EKB po përgatit dokumentacionin projekt, preventiva tip dhe dokumentacionin tjetër teknik për aplikimin për leje ndërtimi. Kemi bashkëpunim me këtë Bashki dhe ne mendojmë se do të fillojmë investimin në fillim të vitit 2025.

Me bashkitë e Dibres, jemi në fazën e bashkëpunimit për ndërtimin e banesave me kosto të ulët.(BKU).

Për objektet e mbartura nga vitet e mëparshme kemi identifikuar të gjitha problemet të cilat në të shumtën e rasteve përgjegjësia i përket vet kontraktorve, të cilët me arsye që nuk justifikojnë mosrealizimet i janë referuar gjithmonë aktit normativ nr.10 datë 18.05.2022.

***Mbi Prokurimet.**

Mbeshtetur në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu II, neni 3, pika 6 "Organet e pushtetit vendor, ndërmarrjet/shoqëritë me kapital mbi 50% shtetëror apo cdo autoritet/ent kontraktor tjetër jobuxhetor përgatisin regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, bazuar në programet e zhvillimit ekonomik dhe në cdo rast jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të buxhetit apo programet e zhvillimit ekonomik nga keshillat vendor ose nga organet drejtuese përkatëse", Sektori i Prokurimeve, përgatit parashikimet e prokurimeve pas miratimit të programit ekonomik.

Mbeshtetur sa më sipër cituar, pavarësisht se verbalisht ju kemi bërë të ditur që Sektori i Prokurimeve nuk merr pjesë në projektin programin ekonomik por pas miratimit të tij, Ju kerkoni që të veprohet në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi sa më sipër cituar.

*** Subvencionimi i interesave të kredive me kushte lehtësuese dhe trajtimi me kredi i familjeve qiramarrëse në ish pronë private.**

Në zbatim të politikave të strehimit të miratuara nga shteti dhe detyrave i janë ngarkuar me aktet ligjore e nënligjore përkatëse për subvencionimin e interesave në përputhje me buxhetin e miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për këtë qëllim, EKB do të vazhdojë gjatë vitit 2024 të kryejë procesin e trajtimit me kredi me kushte lehtësuese, në zbatim të Ligjit Nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, për:

- trajtimin me kredi me kushte lehtësuese me 0% interes në vit për të gjithë familjet e pastreha që banojnë në pronat e subjekteve të shpronësuara.
- subvencionimin e interesave të kredive për familjet e pastreha që janë trajtuar me kredi të lehtësuara me 3% interes në vit nga bashkitë respektive.
- subvencionimin e interesave të kredive për punonjësit e administratës së lartë shtetërore që kanë përfituar kredi të lehtësuara me 4 % interes në vit.
- trajtimin me kredi me kushte lehtësuese me 0% interes në vit për punonjësit e administratës publike si dhe për mjekët, ushtarakët dhe policinë, (VKM 468 datë 26.07.2023, VKM 469 datë 26.07.2023, VKM 400 datë 19.06.2024)

*** Zbatimi dhe rishikimi i legjislacionit ku mbështetet veprimtaria e institucionit**

Përsa i përket rishikimit apo përmirësimit të legjislacionit përkatës në fuqi, në zbatim të të cilit zhvillohet kryesisht veprimtaria e institucionit apo një pjesë e kësaj veprimtarie, nga EKB do të punohet për të përmirësuar këtë legjislacion duke përqëndruar punën në këto drejtime:

- a) Hartim të propozimeve mbi iniciativa ligjore për aktet e evidentuara dhe të tjera që mund të rezultojnë të nevojshme, konkretisht pjesmarrjen në grup pune dhe dhënien e propozimeve përkatëse për projektvendimin për përcaktimin e rregullave të posaçme për miratimin e dokumentit të pronësisë për banesat e ndërtruara me fonde publike nga EKB dhe ato që i kanë kaluar nga të tretët;
-ndjekje të iniciativave të propozuara ministrisë përgjegjëse për strehimin gjatë vitit 2024 dhe që ende nuk janë miratuar;
-dhënie mendimi mbi propozimet e ardhura nga ministritë apo institucionet përkatëse lidhur me iniciativat ligjore që mund të ndërmerren nga këta të fundit.
- b) Hartim të akt-marrëveshjeve të bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe me institucione të tjera në funksion të ndjekjes dhe zbatimit të politikave të strehimit për familjet në nevojë dhe investimeve që miratohen nga Këshilli Drejtues.
- d) Bashkëpunimi në hartimin apo përpunimin e akteve normative të institucionit, kontratave tip apo udhëzimeve të brendshme sipas nevojave të institucionit që mund të prezantohen gjatë vitit 2025 me qëllim për të qartësuar, saktësuar dhe përmirësuar procedurat që kryhen nga strukturat e EKB-së, në zbatim të detyrave funksionale dhe atyre të ngarkuara, për të arritur realizimin e objektivave të përcaktuara.

***. Ndjekja dhe monitorimi i proceseve gjyqësore**

Ndjekja dhe monitorimi i proceseve gjyqësore për vitin 2025 do të kryhet në bashkëpunim me strukturat në qendër si dhe të gjitha strukturat në rrethe, me qëllim monitorimin si dhe përfaqësimin e këtyre proceseve në të gjitha shkallët e gjykimit në një nivel profesional, duke u përqëndruar në drejtim të:

- ndjekjes në vazhdimësi të proceseve të evidentuara që nga viti paraardhës që janë aktualisht në proces gjykimi dhe do vijojnë të ndiqen edhe gjatë vitit 2025 për proceset gjyqësore që mbulohen nga Drejtoria e Përgjithshme, por edhe nga ato që mbulohen nga degët rajonale të EKB-së.
- monitorim të hapjes së proceseve të reja gjatë vitit 2025 të planifikuara nga degët rajonale ndaj klientëve debitorë në zbatim të Manualit të Menaxhimit të Debitorëve ku sipas planifikimit dhe specifikimit të dërguar nga këto dege janë parashikuar të hapen 80 procese gjyqësore gjatë këtij viti, që do ti gjeni të pasqyruara në tabelën bashkëlidhur materialit (tabela përmbledhëse e proceseve gjyqësore të planifikuara për tu hapur gjatë këtij viti);
- ndjekjes së proceseve të tjera të parashikuara të cilat mund të hapen gjatë vitit 2025 ndaj EKB-së nga persona juridikë apo fizikë, si dhe të proceseve gjyqësore që mund të hapë vetë EKB në rastet kur strukturat përkatëse në varësi të problematikave të evidentuara dhe në zbatim të detyrave që u janë ngarkuar relatojnë kërkesën së bashku me materialet e provat për hapjen e proceseve gjyqësore, mbështetur në gjurmën e auditit për proceset gjyqësore të miratuar nga Këshilli Drejtues, si dhe në përputhje me legjislacionit në fuqi brënda afateve të parashkrimit.

*** Kryerja e procedurave përkatëse në funksion të veprimtarisë që kryen Këshilli Drejtues i Entit Kombëtar të Banesave**

- Gjatë vitit 2025, referuar Programit Vjetor të Veprimtarisë së Këshillit Drejtues që do të miratohet për këtë vit kalendarik, si dhe në varësi të problematikave të ndryshme të dala gjatë kryerjes së veprimtarisë së përditshme të institucionit, do të përgatiten nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme materialet përkatëse të cilat do t'i paraqiten Këshillit Drejtues për shqyrtim dhe vendimarrje.

Bashkëlidhur këtij relacioni si pjesë përbërëse tij janë tabelat;

- Tabela 1, Pasqyra e të ardhurave
- Tabela 2, Pasqyra e shpenzimeve
- Tabela 3, Pasqyra e rezultatit financiar
- Tabela 4, Pasqyra e Cash-Flow-t

- Tabela 5, Pasqyra e arkëtimeve
- Tabela 6, Pasqyra e financimit të investimeve dhe shpenzimeve të veprimtarisë
- Tabela 7, Parashikimi i ecurisë së likuidimit të investimeve
- Tabela e proceseve gjyqësore të planifikuara për tu hapur gjatë vitit 2024